Enkelejd
LAMAJ
Kërcimi i parë
TREGIM

KËRCIMI I PARË

Short Story

Published by Enkelejd Lamaj at Smashwords
Copyright, 2011, by Enkelejd Lamaj
Discover the author page at Smashwords:
http://www.smashwords.com/profile/view/enkelejdlamaj

Smashwords Edition, License Notes
Thank you for downloading this free ebook. Although this is a free book, it remains the copyrighted property of the author, and may not be reproduced, copied and distributed for commercial or non-commercial purposes. If you enjoyed this book, please encourage your friends to download their own copy at Smashwords.com, where they can also discover other works by this author. Thank you for your support.

Write: elamaj@live.com

KËRCIMI I PARË

Nuk ndodhi siç e kishte lexuar nëpër libra, apo siç e kishte parë rëndom nëpër filma. Asnjë parandjenjë, asnjë ëndërr paralajmëruese. Asnjë shenjë paraprake për t'u interpretuar.

Asgjë.

Në orën tetëmbëdhjetë e dhjetë (Shikoni? Asnjë rastësi numrash as tek ora!) të së shtunës, Suelën, që ishte duke u menduar se cilin fustan të zgjidhte, e morën në telefon dhe, pa një, pa dy, e pyetën:

– Më falni, me zonjën Suela Gjini flas?

– Po?

– Gruaja e *Edmond* Gjinit?

Pak hezitim nga ana e Suelës, para se të përgjigjej: – Po, unë jam. Me kë flas, ju lutem?

– Përshëndetje zonjë. Jam doktor Bardhi Niko. Nga Spitali Ushtarak Qendror Universitar, ju telefonoj. Të më falni që... po më duhet t'jua them në këtë mënyrë, por burri juaj ka pësuar një aksident të rëndë, zonjë. Me makinë. Ju lutem, a mund të....

Por, pjesa tjetër e fjalisë, humbi bashkë me ndjenjat e Suelës.

Pak më vonë, kur hapi sytë, e pa vetën të shtrirë në krevatin e gjumit, në të njëjtën dhomë kur dhe i... i... *i kishin çfarë*? Për disa çaste mendja e saj u end si e mpirë, nëpër ca rrugica të verbra, pa fund e krye, që të çonin gjithnjë në të njëjtin vend. U ngrit ndenjur. Tek këmbët e krevatit ishte fustani i zi që ia kishte marrë motrës së vogël. Grifshës numër tre. Krisht çfarë lufte! I ishte dashur një ditë e tërë me telefonata dhe lutje që ajo t'ia jepte. E të mendoje që, deri dje, Dorela as që e dinte që e kishte; nuk e kishte veshur qoftë edhe një herë të vetme, por vetëm e vetëm sepse ia kërkoi ajo, iu tek ta kishte për zemër dhe që – pa dëgjoni pak! – donte ta vishte pikërisht atë natë. Suelës iu desh t'i premtonte çantën *Channel* për ca herë dhe të mallkonte veten pse kishte lënë vrapin nga liqeni.

Motra tjetër, Landa (emri i koduar: Grifsha numër dy), kur mori vesh për dasmën, i vuri në dispozicion të gjithë garderobën e saj.

– E ç'merresh kot me grifshën e vogël! – i tha. – Hajde tek unë e zgjidh çfarë të duash.

Por çfarë mund të zgjedhë një grua e masës dy tek një e masës pesë?

Po një e masës tre, mund të zgjedhë gjë?

Suela nuk ia vuri veshin atij zëri. Edhe pse e kishte lënë vrapin nga liqeni, prej më shumë se tri muajsh, ajo vazhdonte të ishte e masës dy.

Megjithëkëtë, fustani ngjyrë trëndafili i Landës i rrinte shumë më mirë se ai i ziu i Dorelës

dhe, në fakt, atë kishte zgjedhur për të veshur, kur...

Kur e morën në telefon dhe i thanë se Edi... *Edi çfarë*?

Dera e dhomës u hap dhe Edi u shfaq tek pragu i saj.

– Mirëserdhe, shpirt! Herën tjetër nuk do të lë të provosh fustane e vetme.

Suela klithi, si një thi i rënë në kurth dhe u hodh prej krevatit drejt e në krahët e tij. E shtrëngoi dhe e mbyti me të puthura.

– Je këtu! Je këtu. Oh, falë zotit je këtu!

– Po, por po nuk më lëshove, nuk do jem edhe për shumë.

Suela e lëshoi, por jo pa e puthur, më parë, në buzë.

– Krisht! – ia bëri pastaj, duke shtrembëruar buzët. – Çfarë ke ngrënë?

– Si mish mu duk.

– Mace e ngordhur ishte?

– Pse, këtë shije ka? Nga e di ti?

– Pse vetëm ti ke jetuar në Qytet Studenti?

Edi qeshi. – Pa më thuaj pak, çfarë të kishte gjetur?

Suela i ra ballit me pëllëmbë. – Një idiot. Një doktor, një farë Bardhi... Bardhi vari leshtë, seç më mori në telefon. Nga qendra spitalore e nënës së vet, kështu tha. Dhe tha se ti kishe pësuar një aksident të rëndë.

Edi vuri buzën në gaz.

– Pa dale pak! – Suela i drejtoi gishtin tregues. – Mos më thuaj se qëndron ti pas asaj telefonate! Ëh? Ti e bëre?

Edi tundi kokën në shenjë mohimi.

– Ti e ke bërë, jam e sigurt për këtë.

– Jo, sinqerisht. Nuk e kam idenë fare.

– Eeeeee... – ia nisi Suela, por kur pa se fytyra e Edit mori një pamje të shqetësuar, mblodhi supet. – Nuk e di atëherë.

– Hajde se e zgjidhim më vonë këtë gjë. Tani të bëhemi gati për t'u nisur.

– Mirë. Po ti bëj ndonjë gjë për atë erën e gojës.

Edi shkoi në banjë.

Një orë më pas, u nisën. Rrugës dëgjuan vetëm muzikë ritmike. Në një moment, Suela pyeti përsëri se cili idiot qe në gjendje të bënte shaka të atij lloji. Edi ia ktheu se, me siguri, vetëm një mjek i qendrës spitalore të nënës së vet dhe të dy qeshën. Kishin arritur tek kthesa për në Arbanë. Edi ndezi sinjalin dhe doli jashtë rruge, ku dhe parkoi.

– Po sikur të mos shkojmë fare? – tha, duke trokitur gishtat mbi timon.

– Të mos shkojmë? Si të mos shkojmë? Pse të mos shkojmë?

Edi anoi pak kokën nga e majta dhe pa qiellin. – Shiko lart, – tha pastaj.

Suela zgjati kokën dhe pa qiellin përmes xhamit të përparmë të makinës.

– Shiko, ç'qiell! Ç'yje! Po sikur të dalim për qejfin tonë sonte? Kush vete e rri kot në dasmë, për të parë se kush është veshur më bukur se kush? Si thua? Hajde e kalojmë ketë natë për veten tonë.

Suela ngriti supet. Në fakt, asaj nuk ia kishte pas dhe aq shumë qejfi për atë dasmë, por Edi pati këmbëngulur, sepse dhëndri qe një prej shokëve të tij të fëmijërisë.

– Po Astriti? Çfarë do thotë Astriti kur mos të të shohë?

– Është shoku im i fëmijërisë. Jam njëqind për qind i bindur se do ma falë.

– Epo... mirë. Po ku do shkojmë?

Edi buzëqeshi dhe vuri makinën në lëvizje.

– Gjithsesi, – ia priti Suela, pak më vonë. – Unë e di që këtë e bëre vetëm e vetëm që të mos kërceje.

– Pse? Jo, s'është ashtu. Unë mund të shkoja dhe të mos kërceja. Nuk do ishte hera e parë.

– E di, e di që ti s'di të kërcesh, por kësaj here do ishte ndryshe. Sepse kësaj here martohet shoku yt i fëmijërisë.

Suela e dinte që po ia fuste kot, por e dinte gjithashtu, që edhe Edi e dinte që ajo e dinte.

Edi tha:

– Unë di të kërcej.

Suela harkoi vetullën. – Dhe unë jam një jashtëtokësore që kam ardhur nga një planet i larguar për të studiuar sjelljen e njerëzve.

– Se përse ke ardhur, këtë s'e them dot, më duhet të besoj në fjalën tënde. Por që bukuria jote s'është tokësore, këtë e kam thënë me kohë.

Suela ndjeu faqet t'i ngroheshin dhe e kuptoi që nuk ishte për shkak të ngrohjes së makinës. Lëvizi dhe i fërkoi krahun.

– E di që sikur po më pëlqen pak më shumë sonte! – tha. – Më thuaj tani, ku po shkojmë? Ose, jo, mos ma thuaj, ma bëj surprizë.

– Po ty s'të pëlqejnë surprizat.

– As ti s'je tip improvizues, por bëre dy improvizime në vetëm pak minuta. S'dua të mbetem prapa.

– Mirë pra. Po nuk do më pyesësh gjersa të arrijmë, dakord?

– Dakord.

Edi buzëqeshi. Në kasetofon, Rona Nishiliu i këndonte zonjës vdekje. Edi zgjati dorën dhe e ndërroi. Elvana Gjata e pyeti në kishte zemër. Edi ktheu makinën drejt Tiranës dhe mëshoi këmbën mbi pedalin e gazit.

Njëzet minuta më vonë, ishin tek zona që njihej si Kodrat e Reja. Edi e ndaloi makinën para një kompleksi prej katër pallatesh me nga njëmbëdhjetë kate secili. Suela, që, deri atë moment, vetëm kishte kënduar së bashku me Elvanën dhe me Evin dhe me Roselën, por edhe me Albanin dhe me Bojkenin dhe me Florin dhe Sonin, sa nuk po i pushonte zemra: makina kishte ndaluar në një prej ëndrrave të saj.

Kodrat e Reja dukeshin nga pothuajse çdo pikë e qytetit, por, se pse Suela kishte idenë se nga apartamenti i tyre dukej më mirë. Çdo mëngjes, ajo ngrihej, shkonte në kuzhine dhe shikonte "Kompleksin" dhe ëndërronte që të jetonin, edhe ata, atje. Madje (kjo është pak e sikletshme!) kishte blerë edhe një palë dylbi marinari, me të cilat e shikonte më mirë.

Edi ishte asnjanës. Edhe donte, edhe s'donte. Ata e kishin pasur mundësinë për të blerë një

apartament, në kohën kur kompleksi pat qenë akoma në themel, por nuk e kishin bërë. Në atë kohë – shtatë vite më parë – pakkujt ia mori mendja se ajo do bëhej zona më e lakmuar e qytetit. Ishte i vetmi vend ku – përveç majave të pallateve – të shikonte syri një tufë të tërë gjelbërimi. Të blije një apartament tani atje, ishte vërtet e pamundur... edhe për një që merrej vetë me ndërtim pallatesh.

Po përse Edi e kishte çuar aty tani?

– Po ku... – nisi ta pyesë, por Edi e ndërpreu: – Shshsh! E lamë që nuk do flisje.

Suela heshti dhe Edi e udhëhoqi përmes një lulishteje të madhe, në mes të së cilës flinte një shatërvan gjigant.

– Ky vihet në punë vetëm ditën, – shpjegoi Edi. – Nga ora tetë deri në gjashtëmbëdhjetë. Kurse natën e fikin, se bën shumë zhurmë.

– Po për se jemi këtu?

– A–ha. Nuk kemi arritur akoma. Unë do të flas, por ti mos bëj pyetje. Zëre se je në një udhëtim turistik dhe unë jam udhërrëfyesi yt.

Ndërkohë ishin pranë hyrjes së asaj që, sipas pllakës, ishte Godina Nr. 3. Suela ndoqi Edin, që iu afrua ashensorit, nxori një çelës të rrumbullakët dhe e futi në të vetmen vrimë, që ndodhej në të majtë të dyerve metalike. Dyert u hapën. Edi u përkul, si një kavalier i dalë nga kushedi cili shekull i largët dhe zgjati dorën drejt ashensorit.

– Ju lutem, zonjë! Pas jush.

Suela improvizoi dy hapa fluture dhe hyri brenda. Edi e ndoqi me një solemnitet të atillë, që Suelës nuk iu ndenj dhe iu hodh në qafë.

– Mos më thuaj se ke marrë një apartament këtu.

Edi zgurdulloi sytë. – Një apartament?! Këtu?!

Dyert e ashensorit u hapën dhe Edi u kthye në Edi Kavalierin e zonjës së vet. Suela doli prej ashensorit në një korridor, në të cilin kishte vetëm një derë. Edi, gjithmonë me një pamje serioze, por që dukej qartë që përbrenda ishte duke u zgërdhirë si dreqi, iu afrua derës dhe trokiti. Suela iu afrua dhe mbajti vesh. Nuk pipëtiu asgjë.

Edi trokiti përsëri. Përsëri asgjë. Kësaj here, pas trokitjes së Edit, trokiti edhe Suela. Më fort dhe më shumë se ai. Kur kaloi gati gjysmë minute pa asnjë përgjigje, Edi psherëtiu dhe futi dorën në xhep.

– Me sa duket më duhet ta bëj vetë, – tha, duke nxjerrë portofolin. Kërkoi mes ndarjeve të tij dhe nxori një si kartë krediti ngjyrë floriri,që e futi në një të çarë, në anën e djathtë të derës, në lartësinë e kraharorit.

Dera u hap dhe, për të tretën herë në pak minuta, Edi i la vendin Kavalierit. Kësaj here, Suela nuk e kishte edhe aq mendjen. Me këmbët që kishin filluar t'i dridheshin dhe zemrën që i ishte ngjitur e tani i rrihte në grykë, kapërceu pragun e derës dhe hyri brenda.

– P-po... po ku...

– Oh, po. Besoj se tani mund të pyesësh, – i tha Edi, duke mbyllur derën pas krahëve.

Vetëm se tani, Suela, nuk po gjente dot fjalët e duhura. Mbasi hapi e mbylli për disa herë, gojën, si një peshk në akuarium, më në fund, bëri si bëri, u kthye nga ai dhe mundi të sajonte

diçka të tipit:

– Mos thuaj më trego kjo është çfarë?

– Shtëpia e re, – tha Edi dhe, Suela, si priti një çast, që të sigurohej që i kishte dëgjuar vërtet ato fjalë dhe nuk i kishte imagjinuar, bërtiti. Pastaj filloi të vinte rreth e përqark. Nuk ishte një apartament normal, si ai që kishte dashur aq shumë. Si ai që kishte parë me dylbi. Ai ishte një kat i tërë... jo, prit! Ishin *dy* kate. Tani që po shikonte me kujdes, vuri re një palë shkallë që të çonin në një kat të dytë. Suela i ngiti shkallët me vrap dhe doli në një korridor të vogël me dhoma, dhoma dhe vetëm dhoma. Nuk guxoi të hynte në asnjërën prej tyre.

Ndjeu Edin pas krahëve. U kthye dhe iu var në qafë.

– Po si? – Me sa dukej, fjalët një rrokeshe ishin të vetmet që mund të shqiptonte në ato çaste.

Edi i vuri gishtin mbi buzë. Pastaj u përkul dhe e puthi lehtë. – Eja! – i tha dhe i tregoi një palë shkallë prej druri në fund të korridorit.

Jo, s'kishte mundësi! Apo kishte?

Kishte dhe që ç'ke me të! Sipër, në tarracë, ishte një kopsht i tërë me lule dhe pemë nga më të ndryshmet. Një park i vërtetë. Në qendër të parkut ishte edhe një pishinë e vogël e veshur me pllaka të kuqe.

Suela kaloi nga një lule në një pemë, nga një pemë në një lule tjetër, si të ishte një flutur e porsaardhur në jetë. Në çdo cep që shkonte, shikonte dritat e qytetit dhe i thoshte me vete: *Tani je i imi! Tani je i imi! Tani...*

Nata u mbush me notat e një kënge, që e la aq të shastisur, saqë, iu deshën disa çaste që t'u besonte veshëve.

Jo, s'është e mundur! Edi këtë këngë?!

Duke matur çdo hap që hidhte, Suela doli nga një tufë palmash, si një këlysh luani në gjuetinë e tij të parë. Tek pishina, Edi, kishte vënë mbi njërën prej karrigeve plastike, një magnetofon gri, nga i cili dilte (*Oh Zot! Jo, s'ka mundësi! Po ja që ka. Jooo. Po si? Oh Zot!*) zëri i Shpatit që të ftonte të hidhje vallen kosovare?!?!

Dhe, mbi pllakat e kuqe që rrethonin pishinën, Edi, me në supe një flamur të madh kuqezi, po e hidhte vallen vërtet.

Suela vuri duart para buze për të mbytur mishmashin e emocioneve që e goditën nga të gjitha anët. Por, në fund, nuk mund të rrinte pa shpërthyer në një të qeshur të madhe. U përkul në dysh, pastaj u ul në gjunjë mbi barin e gjelbër dhe lotët i rrodhën çurg. *Jo vetëm që ishte hera e parë që Edi po kërcente një valle popullore, por sa bukur që po kërcente, dreqi!* Ky mendim iu ngulit në mendje dhe filloi t'i përsëritej si një disk i prishur.

Pastaj, pa pritur, si të ishte përmendur nga një

(*humbje ndjenjash*)

gjumë i thellë, u ngrit me vrik dhe iu bashkua Edit në kërcim. Erdhën rreth e përqark pishinës, duke kërcyer me të njëjtin ritëm, hynë midis palmave, i erdhën rrotull një pishe, pastaj një vargu të gjatë me trëndafila, pastaj dolën sërish tek shatërvani me pllaka të kuqe. E hodhën vallen, herë duke u ngritur në ajër, herë duke rënë në tokë, e herë duke u rrotulluar rreth njëri – tjetrit... dhe shpirtrat ua rrëmbeu dashuria dhe vallëzuan e, me siguri diku, do krushq e ngritën

një dolli, e dikush tjetër i pati zili dhe e hodhën vallen si sorkadhe dhe dahiret ranë e u çanë dhe në vallen kosovare, sa hije iu pat yll' i dashurisë!

Kur kënga mbaroi, ashtu, ujë në djersë siç qe, Suela e pushtoi Edin prej beli dhe të dy ranë në ujin e pishinës. U përqafuan dhe u puthën. U zhytën dhe pinë nga një gllënjkë ujë. U kollitën fort. Pastaj u puthën prapë. Dhe pinë ujë përsëri.

– Ka një frigorifer të vogël, aty, – tha pastaj Edi. – Më mirë të pimë atë që ka aty brenda.

Dolën jashtë dhe, pa u merakosur për rrobat, u shtrinë dhe panë yjet.

– Ti je i çmendur! – tha Suela. – Gjithkush do kishte zgjedhur diçka tjetër, kurse ti... *Shpat Kasapin*?

– Ti më preke në sedër? S'kisha ç'të bëja.

– Për kokën tënde, ti je i paparë! Po si s'të filmova pak. Sa keq! *Uaaaa*! – Suela u ngrit ndenjur dhe filloi të rrëmonte nëpër xhepat e mbushur me ujë. Kur nuk gjeti gjë, u qetësua. – Thashë se e laga celularin. Sa mirë që e paskam harruar!

Edi zgjati gishtin në drejtim të yjeve. – Po tani? Ç'do t'u thuash bashkëkombësve të tu jashtëtokësorë?

Suela u mendua për një çast. – Që toka duhet shkatërruar një orë e më parë. Por, më parë, duhet marrë një kampion mashkulli i vërtetë.

– Hëm! – ia bëri Edi.

– E ke idenë ku mund ta gjej ndonjë?

Edi ngriti dorën. – Këtë e prisja.

Suela ia toku. – Edhe unë e prisja që ti e prisje. Po tani, më trego, si e sajove gjithë këtë gjë?

Edi ia tregoi.

Shumë më vonë, morën makinën dhe u kthyen në apartamentin e tyre, poshtë në botën e të vdekshmëve të zakonshëm. Suela mori rrobat e të dyve dhe i futi në rrobalarëse, por nuk e ndezi, për të mos bërë zhurmë. Pastaj bënë një dush dhe u shtrinë.

– Edi?

– Po.

– Nuk kam për ta harruar kurrë mbrëmjen e sotme.

– E di, shpirt. As unë.

– Të dua shumë.

– Të dua shumë edhe unë.

Pas një copë here, Suela foli përsëri. – Ishte mbrëmja më e bukur e jetës sime, – tha.

Edi nuk foli.

Fjetën të dy, ngjitur e ngjitur, derisa celulari i Suelës tringëlliu. Përgjumësh, ajo u çua dhe vuri re se Edi ishte ngritur para saj. Dita kishte filluar me kohë dhe rrezet e diellit hynin përmes perdeve, si tehe shpatash.

Dhe zilja e celularit vinte nga një vend i çuditshëm... vinte nga... *poshtë saj*?! Të qe e mundur? Pastaj u kujtua. Qysh mbrëmë, kur i kishte rënë të fikët nga ajo telefonata e atij doktor idiotit, nuk e kishte parë më celularin me sy. Me siguri që, atë çast i ka rrëshqitur poshtë krevatit.

Celulari pushoi së tringëlluari. Gjithsesi, Suela zbriti prej krevatit dhe u ul ta marrë. Kur i

ndezi ekranin, pa që kishte plot pesëdhjetë e shtatë thirrje të humbura.

Zgurdulloi sytë dhe i zgurdulloi akoma edhe më shumë kur pa se të gjitha thirrjet vinin nga i njëjti numër. Dhe ishte një numër *fiks*. Një numër që... *po pse më duket sikur e kam parë edhe diku tjetër?*

Celulari tringëlloi përsëri.

Numri *fiks* pulsonte në ekranin e vogël të celularit.

Mos e hap, Suela! Mos e hap! Është ai. Ai doktori. Do të të thotë për Edin. Mos e hap!

Suela e futi celularin poshtë jastëkut. Ai vazhdoi të tringëllojë edhe për pak çaste të tjera, pastaj pushoi. Suela doli në korridor.

– Edi. Edi?

Në vend të Edit, iu përgjigj zhurma e një çelësi që rrotullohej në bravë. Suela vuri buzën në gaz dhe shkoi t'i dilte Edit përpara.

Në derë u shfaq Grifsha numër tre.

– Dorela?! Po ti ç'do këtu?

Dorela shfryu. – Një minutë punë. Sa të marr fustanin dhe iki,– tha, si duke pëshpëritur. – Edhe çantën e Shanelit, – shtoi pastaj, me të njëjtin ton zëri.

– Po po po, sa e paparë që je! – ia priti Suela, duke qeshur. – Grifshë sa për gjitha grifshat! – Gjithsesi, pak i interesonte. Për fat, mbrëmë ra në pishinë me fustanin e Landës! – Ik, në dhomën e gjumit i ke, – tha pastaj dhe vetë iu drejtua banjës.

Ishte akoma në banjë, kur dëgjoi një zile celulari të oshtinte nëpër shtëpi.

Është ai. Është përsëri ai. Do të të thotë për Edin. Lëre fare. Mos u ço hiç!

Pastaj dëgjoi zërin e Dorelës:

– Alo? Hë... Po. Jo, jam tek Suela. Si?... Epo sot vijnë ca për shtëpinë dhe erdha të marr fustanet... Mirë, në rregull. Do kaloj. *Ciao!*

Një çast më pas, dëgjoi derën e jashtme që u hap dhe u mbyll, pastaj çelësin të rrotullohej në bravë.

– Ua, debilja! Po si ikën kështu? – i tha Suela banjës, teksa u zgjat të merrte peshqirin. – Dorela? DORELAAA!

Suela u fshi, pastaj doli në korridor, pikërisht në çastin që brava filloi të kërciste sërish.

Po, patjetër, Dorela nuk mund të ikte në atë mënyrë!

Por: – Oh, mos u bëni merak, – dëgjoi një zë të panjohur. – Ajo është kunata e vogël e Edit. Urdhëroni!

Një çast më vonë, në shtëpi urdhëruan dy të rinj, që dukeshin moshatarë me atë dhe Edin, si dhe një burrë, që, fare mirë, mund të qe babi i saj.

– Shikoni nga të doni, – tha burri, duke ndezur dritën e korridorit.

– Ore, dale pak, dale pak! – Suela iu drejtua burrit që mbante në dorë, tufën e çelësave të shtëpisë së saj. – Ku dreqin shkoni kështu?

– Domethënë kjo shtëpi shitet për arsye *familjare*, ëh? – ia priti vajza, që, ndërkohë kishte hyrë në kuzhinë. Instinktivisht Suela u kthye andej dhe burri përfitoi t'i përvidhej sulmit të saj. Njëkohësisht tha: – Pak a shumë, po. Prandaj ka këtë çmim kaq të lirë.

– Po ato zërat që kemi dëgjuar? – u hodh e tha djali. – Do na tregosh tani?

Burri kaloi gishtërinjtë mes flokëve të dendur dhe para se Suela t'i tërhiqte vëmendjen tha: – Keni të drejtë, jua premtova të vërtetën. Se ju më dukeni shumë çift i mirë. – Psherëtiu, pastaj u kollit si për të qëruar zërin, por Suelës iu duk se ai po kërkonte fjalët e duhura. – Deri para pak javësh këtu ka jetuar një çift i ri, ja kështu si puna juaj.

Suela ngriu. Pranë tavolinës, në kuzhinë, djali iu afrua të dashurës së tij nga prapa dhe e përqafoi.

– Një natë, Edi, djali, vëllai i atij që takuam dje tek "First"–i, pësoi një aksident të rëndë. Kthehej nga Vlora, ku kishte pasur një takim pune për atë Hecin atje. Kthehej me nxitim, i shkreti, sepse atë natë duhej të shkonin në dasmën e një shoku të tij të fëmijërisë. Por një kamion parakaloi në kthesë dhe e mori para, për nja pesëdhjetë metra të mira, në mos më shumë. Kur përfundoi në Spitalin Ushtarak, kishte tri fraktura vetëm në kokë e dëmtime të tjera, që zor se numëroheshin. Po atë natë, mjeku i turnit, duke u nisur nga dokumentet që iu gjetën me vete, mori në telefon gruan e tij, që ta njoftonte. Por ajo e priti lajmin shumë keq. – Burri heshti për disa sekonda, pastaj vazhdoi. – Ndoshta doktori do kishte bërë mirë të kishte gjetur një mënyrë tjetër njoftimi, po nga ta dinte ai! Ndoshta, në fatin e keq të të gjithëve, ndikoi edhe një lapsus i gazetares që dha lajmin për herë të parë, e cila, në vend të thoshte se ai që vdiq në vend kish qenë shoferi i kamionit dhe ai që u shoqërua me shpejtësi për në Spitalin Ushtarak qe ai i fuoristradës, tha të kundërtën. Po ky është vetëm një hamendësim.

Për një çast nuk foli askush. Vajza dhe djali shikonin dyshemenë tek këmbët e tyre. Burri kruante thonjtë. Suela vazhdonte të tundte kokën në shenjë mohimi. Nuk ishin të vërteta. Asgjë nga ato që po thoshte ai njeri, nuk ishte e vërtetë. Ajo, vetëm mbrëmë kishte qenë me Edin në apartamentin që ai kishte blerë te Kodrat e Reja. Ja, përse ishin aty ata! Me siguri që Edi po kërkonte ta shiste apartamentin sa më parë. Pastaj, a nuk e kanë pasur gjithnjë në plan për ta shitur? Po pra! Po ç'dreqin qe ajo histori idiote? Apo nuk donte ky që shtëpia të shitej?

Suela mblodhi grushtet gjithë inat dhe bëri drejt atij gënjeshtari të ndyrë, por këmbët nuk iu binden. Dhe vetëm atëherë e kuptoi se, gjatë gjithë kohës, ajo kishte qëndruar tek pragu i derës së kuzhinës, pa e kapërcyer dot atë.

– Ajo plaka e katit të parë... – nisi të thotë djali, por burri e ndërpreu.

– Po, po e di. Sipas saj, Edi vjen këtu çdo natë dhe merr gruan e tij dhe shkojnë në apartamentin e tyre të ri, te Kodrat e Reja. Ja! – Burri u çua dhe iu afrua dritares së kuzhinës. Mori dylbitë që ndodheshin mbi parvaz dhe ia zgjati djalit. – Suelës i ishte bërë si gangrenë dëshira për të pasur një apartament atje. Nuk kishte ditë, që të mos vinte tek kjo dritare dhe të shikonte me dylbi andej. Edi sapo e kishte blerë një apartament aty dhe kishte ndërmend, që, po atë natë, pas dasmës, t'ia bënte surprizë.

Djali vuri dylbitë dhe nisi të shikonte jashtë dritares. Vajza pyeti:

– Po gruaja e tij?

Burri u kthye nga ajo: – Suela? Nga telefonata e mjekut duhet t'i ketë rënë të fikët. Të paktën kështu mendon mjeku, sepse, në një çast gjatë komunikimit, ka treguar ai, dëgjoi një zhurmë përplasje dhe Suela nuk iu përgjigj më pyetjeve të tij dhe as reagoi teksa ai i thoshte se

burri i saj nuk kishte vdekur akoma. Në fund, mjeku i dha fund telefonatës dhe dha alarmin, por, kur një patrullë policie shkoi në vend, e gjeti të shtirë, ja, mu këtu, në mes të kuzhinës. Nga autopsia doli që kishte pirë të gjitha kokrrat e valiumit që kishte në shtëpi.

– Sa e tmerrshme! – komentoi vajza.

– Sipas raporteve të mjekësisë, rezultoi se vdiqën në të njëjtën kohë. Ai në shtratin e spitalit, ajo këtu, në kuzhinë.

– E tmerrshme! – përsëriti vajza.

Djali u kthye një herë nga vajza e tij, pastaj nga burri. – Do na duhet të mendohemi pak për shtëpinë. Të vjen keq ta diskutojmë edhe një herë tjetër mes nesh? Them se nesër pasdite do e kemi një përgjigje përfundimtare, apo jo shpirt?

Ajo tundi kokën në shenjë pohimi.

– Patjetër, – tha burri.

Suela u tërhoq në dhomën e saj. Ngriti duart para syve. I këqyri me kujdes. U kujtua. Vërtet mjeku nuk i kishte thënë nëse kishte vdekur, por toni i zërit nuk i kishte lënë asnjë shteg. Si mund të vazhdonte jetën pa Edin? A mund ta kishte vazhduar? Po kur ndezi televizorin? A do kishte ndryshuar gjë, nëse ata të *Njuzit* do e kishin dhënë lajmin të saktë që në fillim? Apo thjesht gjithçka do ishte shtyrë për disa orë? Nuk diti si të përgjigjej. Nuk diti çfarë të ndjente. Kur, vonë, në darkë, Edi u shfaq tek pragu i derës, ajo iu hodh në qafë.

– Oh, Edi! Çfarë paskemi bërë kështu!

Ai e shtrëngoi pas vetes. I ledhatoi flokët. Qëndruan ashtu derisa koha e humbi konceptin e saj dhe Suela përsëriti: – Çfarë paskemi bërë kështu!

– Më duket se unë kërceva *për herë të parë në ekzistencën* time, – iu përgjigj Edi.

Atëherë, Suela, u shkëput prej kraharorit të tij dhe buzëqeshi. – A ikim kërcejmë prapë për herë të parë?

Edi i ledhatoi mjekrën, pastaj i kaloi gishtin e madh mbi vetull. Në fund, u tërhoq disa hapa pas dhe i la vendin Edi Kavalierit. – Më lejoni t'ju shoqëroj, e shtrenjta ime! – i tha ai.

###

NË TË GJITHA LIBRARITË

libri i bardhë

LIBRI I BARDHË

Një gjë po bëj të qartë që në fillim: nuk po e shkruaj me entuziazëm këtë histori. Përkundrazi! Po fajin e kam vetë; fajin e ka ky kurioziteti im i qelbur që veç telashe më ka sjellë gjithmonë. Fajin e kanë sytë e mi, që të verbër u bëfshin e më rreze drite mos pafshin! Sinqerisht! Njëqind herë më mirë sikur ajo makinë e mallkuar të më kishte përplasur e të më kishte kaluar përsipër më të katërta rrotat. Vetëm brenda saj të mos kisha parë!

Dhe, mbi të gjitha, të mos kisha shkuar për ta vërtetuar.

Emri im është Romeo, mbiemri si ta doni, mosha 57 vjeç. Banoj vetëm një derë larg komshiut tim të mallkuar që shkoi e bleu librin e bardhë dhe po aq larg komshiut tjetër të shkretë që erdhi dhe pranoi ta merrte.

Në fakt, të mallkuar e të shkretë duket se jemi të gjithë ne që jetojmë në Rrugicën 'Tonë'. Një natë mora një laps e një letër dhe fillova të shkruaj emrat e të gjithë atyre që njihja në këtë rrugicë dhe zbulova se pak më shumë se shtatëdhjetë për qind e jona janë të ve ose të ndarë prej vitesh. Unë dhe komshiu im i mallkuar jemi të ve, kurse komshiu i shkretë, ai është anëtar i të ndarëve.

Të paktën kjo ishte ajo që dinim. Aq më tepër që këtu të shtynte edhe logjika. Kur ti je duke përshkuar kilometrin e pesëdhjetenjë dhe gruaja jote atë të tridhjetepestin; kur ti ecën me një ritëm të konsiderueshëm dhe pak gjëra të tërheqin vëmendjen majtas e djathtas dhe gruaja jote tërhiqet nga pothuajse çdo ngjyrë e peizazhit, herët a vonë, edhe kilometrat fillojnë e zgjaten gjithnjë e më shumë drejt dy rrugëve të ndryshme, derisa arrijnë në udhëkryqin e famshëm ku çdonjëri do marrë, në mënyrë të pashmangshme, një rrugë të ndryshme.

Komshiu im i shkretë, këtë udhëkryq, e arriti para pothuajse tre muajsh. Zhurmat që shoqëruan mbërritjen në atë udhëkryq dhe marrjen e dy rrugëve të ndryshme i dëgjova pothuajse të gjitha, pavarësisht mureve të trasha dhe metrave katrorë plot bimësi që ndanin shtëpitë tona. Ora një e natës pastaj, është ideale për të shtuar, në drejtim të përmirësimit, vetinë e të dëgjuarit. Por, si për dreq, është edhe ora kur qepallat e syve të mi rëndojmë më shumë se në çdo orë tjetër. Them si për dreq, sepse mbasi dëgjova sa dëgjova dhe arrita në përfundimin se ky ishte udhëkryqi i famshëm që pritej të mbërrinin hë sot hë nesër, u shtriva të flija dhe nuk e pashë, realisht, rrugën që mori gruaja e komshiut tim të shkretë. Një tjetër si–për–dreq është fakti që dhoma ime e gjumit bie nga ana e komshiut tjetër, atij të mallkuarit. Atij që një javë më pas shkoi e bleu librin e bardhë.

Për herë të parë në rrugën e re që mori, komshiun e shkretë e pamë dy ditë mbasi ky qe

detyruar të merrte atë rrugë. Batutën do kisha dashur t'ia kisha bërë vetë, por ai u tregua më i shkathët dhe e bëri vetë mirëseardhjen në klubin e beqarëve. Unë dhe komshiu tjetër, ai që më pas do bëhej i mallkuari, po pinim raki në avllinë time. Trokitëm gotat të tre dhe një jetë e re nisi në rrugicën tonë. Që nuk do të zgjaste shumë, gjithsesi.

Unë dhe komshiu i mallkuar mund të vinim në ndihmë vetëm për sa i përket mënyrës së shtyrjes së rrugës që porsa kishte marrë tani, komshiu i shkretë, porse, në lidhje me arsyen, duke qenë se e kishim të ndryshme, nuk bëmë komente.

Komentet ia lamë vetë komshiut të shkretë.

– E dija që herët a vonë do të ndodhte, – tha, më në fund, një ditë dhe ishte pikërisht një ditë para librit të bardhë. – Dikur ka qenë një shprehje me të cilën talleshim kur kemi qenë të vegjël. Ajo që thoshte të mos e merrje gruan e vogël se të linte pa gjumë, por mos ta merrje as të madhe se nuk të mbante shumë... paskësh qenë e kundërta!

Pastaj tregoi për vrapin e mëngjesit që kishte filluar e shoqja, tashmë ish, para një viti, për edhe palestrën që kishte filluar para gjashtë muajsh, për orët e vona në punë, për shërbimet jashtë shtetit. Të gjitha këto shenja që makina e saj po ngadalësonte shpejtësinë, ndërkohë që ajo e atij ecte rregullisht përpara derisa diferenca e kilometrave, boll e madhe për shkak të natyrës, u bë akoma edhe më e madhe.

– Gjithsesi vetmia qenka e tmerrshme!

E kujt po ia thoshte ai këto: mua dhe komshiut të mallkuar? Mbas vetëm një jave?! Nuk i komentuam fjalët e tij. Por filluam të thoshim se ishim ende të rinj, se jeta ishte akoma edhe shumë e gjatë, se rrugët e saj janë plotë me të papritura dhe kush e dinte?... ndoshta shumë shpejt jeta do fillonte të buzëqeshte sërish. Nuk di dy të tjerët, por unë as që mendohej se mund të gënjeja veten me ato gjëra, por minutat rridhnin, makinat tona të jetës ecnin në të njëjtin drejtim dhe, ç'ishte më e rëndësishme, shishet e rakisë rreshtoheshin njëra mbas tjetrës tek këmbët e atij që e kishte sjellë.

Vetëm se të nesërmen, komshiu im i mallkuar se nga vete e psonis një libër të bardhë.

Në fakt nuk ishte një libër, në kuptimin e plotë të fjalës. Por ideja ishte që, ato fletë të bardha si dëbora e parë, të ktheheshin në një libër, prandaj dhe u pagëzua me atë emër. Tani... epo mirë, do e them: isha unë që e pagëzova me këtë emër, po nuk besoj se ngjarjet do të kishin rrjedhur ndryshe në qoftë se atyre fletëve të bardha, të lidhura me njëra – tjetrën në mënyrë profesionale, do i kisha vënë emrin tavë me patëllxhanë.

A jua kam thënë emrin e komshiut të mallkuar? Më duket se jo. Madje as atë të komshiut të shkretë nuk ju kam thënë, e kam mirë? Mos më vini faj: po të kishit parë edhe ju atë që pashë unë në timonin e asaj makine, atë mëngjes, kush e di se sa gjëra të tjera do linit pa thënë.

(...)

###

Connect with Enkelejd Lamaj Online

The Official Blog: http://enkelejdlamaj.com/
Twitter: http://twitter.com/
Facebook: http://www.facebook.com/pages/Enkelejd-Lamaj/163287560389935
Write: elamaj@live.com